<sup>4</sup>Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019.

### 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a) Xhiroja mesatare vjetore e realizuar gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 duhet të ketë një vlerë minimalisht sa vlera e objektit të tenderuar, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

b) **Kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet 2017, 2018 dhe 2019**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet.

### 2.3 Për kapacitetin teknik:

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si me poshtë:**

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm të së njëjtës natyrë në një vlerë jo **më të vogël se 50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit;

ose

**b-** Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël** se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacioni e mëposhtëm:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Aktin e kolaudimit;
  5. Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punimeve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Faturat tatimore për çdo situacion punimesh
  5. Aktin e kolaudimit;
  6. Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

*Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqes/in kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.2** Operatoi Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 145 punonjës për periudhën **Janar 2019 – Shtator 2020**, e vërtetuar kjo me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Janar 2019 – Shtator 2020**,
- b) Listë-pagesat e punonjësve sipas formulait që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Janar 2019 – Shtator 2020**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

### 2.3.3 Për kapacitetin teknik:

Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vëndim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies se liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrjnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e Operatorik Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### **Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

1. N.P.1–B Punime gërmimi në tokë
2. N.P.2 –B Ndertime civile dhe industriale
3. N.P.3 –B Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
4. N.P – 5B Punime nentokesore, ura e vepra arti
5. N.P.7 –C Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
6. N.P.12 –B Punime të inxhinierisë së mjedisit

- **Për punimet special të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:**

1. N.S.1 – A Punime për prishjen e ndërtimeve
2. N.S.16 –A Ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij
3. N.S.18 –B Punime topogjeodezike
4. N.S.20 –A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.

#### **sipas modelit të lëshuar nga MPPT**

*Shoqërië e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e liçensave profesionale që disponojnë lë lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Republika e Shqipërisë, siç përcaktohet tek “Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrjnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008”.*

### 2.3.4 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet

- a) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm:

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- |                           |         |
|---------------------------|---------|
| 1) Ing. Ndërtimi          | 2(dy)   |
| 2) Ing. Hidroteknik       | 2 (dy)  |
| 3) Ing. Elektrik          | 2 (dy)  |
| 4) Ing. Mekanik           | 2 (dy)  |
| 5) Ing. Topograf /Gjeodet | 2 (dy)  |
| 6) Inxhinier Mjedisi      | 1 (një) |
| 7) Inxhinier Gjeolog      | 1 (një) |

*Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se Inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.4 dhe punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.2 janë të paamgazhuar në kontrata të tjera.*

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për periudhën për 6 muajt e fundit.

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme)
- Diploma
- CV
- Librezë pune

b) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kuaifikuar/certifikuar si:

- Shoqëria duhet të ketë në stafin e saj jo më pak se: 3 punonjës Teknik ndërtimi, 2 teknike topograf, 3 punonjës elektrikist, 4 hidraulik, 1 montues tubash ujesjellesi, 2 mekanik, 2 saldatorë, 2 karpentier, 3 hekurthyes, 3 muratore, 2 hidroizolues, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr.13/2013.

**Për të cilët duhet të paraqiten:**

- Kontratë pune
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për 6 muajt e fundit.
- Diplomat, çertifikatat ose dëshmite përkatëse

Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) inxhinier të disponojë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e igjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 1 (një) inxhinier specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dëshmuar me kontratë pune dhe certifikata perkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.
- 1 (një) Inxhinier Auditues i Energjisë (i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë), e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Repunlika e Shqipërisë.
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë e lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.
- 1 (një) punonjes i cili të disponojë certifikatën për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjncave.

### **Për stafin e mësipërm të paraqiten:**

- Kontratë pune te vlefshme
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për 6 muajt e fundit.
- Diplomat dhe certifikatat perkatëse

c) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të ketë në safin e tij **1 (një) mjek** në bazë të të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Per Masat e Vecanta te Sigurimi të Mbrojtjes së Shëndetit në Punë”, i ndryshuar dhe te Ligjit Nr.10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e speciaizuarqë merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve që plotëson kriteret e VKM 742 datë 06.11.2013, duhet të ketë pjesë të stafit 1 të tij (një) mjek të përgjithshëm.

*(Marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e deyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës).*

### **Për të cilin duhet të paraqisni:**

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë
- Urdhër Mjeku
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 6 muajt e fundit.

d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) me Kodin III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportimin e mbetjeve urbane”, III.1.A “Per ndikimin ne mjedis” dhe I.2.A”.

3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, me eksperiencë pune minimuni 10 vjet dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumenacionin e mëposhtëm:

- i. Librezë pune (përkatëse)
  - ii. CV përkatëse
  - iii. Diplomë
  - iv. Kontratë pune e noterizuar
1. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës buldozieriste, 4 (kater) punonjës automakiniste dhe 5 (pese) eskavatoristë. Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejimit (të vlefshme), lëshuar nga insitucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 6 muajt e fundit.
  2. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesin Certifikatat e cilësisë së punimeve:
    - **EN-ISO 9001** mbi ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
    - **EN-ISO 14001** mbi (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
    - **BS OHSAS 18001/2007 ose ISO 45001/2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
    - **BS PAS 99** (Sistemi i menaxhimit të integruar).
    - **ISO 50001** (Sistemin i menaxhimit të energjise).
    - **ISO 39001** (Certifikatë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor).
    - **ISO EN 3834-2:2006** “(Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike).
    - **SA 8000** (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësive shoqërore)
    - **ISO 1452-1** (Sistemi i tubacioneve plastike)
    - **DS CEN 15128** (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit).
    - **BS EN 13331-1 2002** ( Sistemet për veshjen e kanaleve)

**Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve*



Dokumenta Standarde të Tenderit

*ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese përkatësisht Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

3. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorik ekonomik, që nevojiten për ekzekuimin e kontratës (Shtojca 10).

Lloji i Makinerive	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues min. 20 ton	4 Copë	Pronësi ose me qera
Kamione vetëshkarkues 15-20 ton	2 Copë	Pronësi ose me qera
Kamione vetëshkarkues 10-15 ton	3 Copë	Pronësi ose me qera
Kamione vetëshkarkues. 5-10 ton	2 Copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine vetëshkarkuese 3-5 ton	3 Copë	Pronësi ose me qera
Kamioncina deri ne 3 ton	3 Copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 Copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 Copë	Pronësi ose me qera
Eskavatorë me zinxhire	5 Copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me krah te gjate	1 Copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 Copë	Pronësi ose me qera
Greider	1 Copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi	1 Copë	Pronësi ose me qera
Bitumatrice (sperkatese bitumi)	1 Copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues gome hekur mbi 10 ton	2 Copë	Pronësi ose me qera
Rrul i dhembezuar	1 Copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur hekur asfalti	3 Copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

Autovinc	1 Copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	1 Copë	Pronësi ose me qera
Vinc kulle	1 Copë	Pronësi ose me qera
Pompe uji	3 Copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji 10000 litra ne total	1 Copë	Pronësi ose me qera
Cekic pneumatik	1 Copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 Copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	3 Copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome (bobcat)	1 Copë	Pronësi ose me qera
Paisje per matjen e presionit (e perbere nga pompa automatike e presionit, sesnsor per matjen e temperatures, sensor per matjen e presionit, ekranin, printerin)	1 Copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	4 Copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 Copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator min 30 kva	2 Copë	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	2 Copë	Pronësi ose me qera
Tokmak (ngjeshes)	3 Copë	Pronësi ose me qera
Aparat per saldimin e tubave	2 Copë	Pronësi ose me qera
Aparat per ngjitje tubo	3 Copë	Pronësi ose me qera
Aparatura per testimin e ngjeshmerise se materialit me metode me goditje (pjate)	1 Copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	9 Copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

Pompe uji	4 Copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 Copë	Pronësi ose me qera
Kontenier per zyra	2 Copë	Pronësi ose me qera
Prerese hekuri	2 Copë	Pronësi ose me qera
Bango hekuri	2 Copë	Pronësi ose me qera
Helikopter nivelimi betoni	2 Copë	Pronësi ose me qera
Makineri vijezi	1 Copë	Pronësi ose me qera
Perzjeres llaci/kolle	1 Copë	Pronësi ose me qera
Sharre asfalti	2 Copë	Pronësi ose me qera
Instrument topografik	1 Copë	Pronësi ose me qera
Kallepe / betoforma	1000 m2	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 110 copë.
- Rripa lidhës sigurimi për punime lartesi minimum 8 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimum 8 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimum 8 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë / Kuti emergjence minimum 8 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimum 40 copë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës , sipas shtojcës nr.10 dhe dokumentacioni si më poshtë.

- a) Për mjetet me rrota që shënohem në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikata e pronësisë së mjetit dhe leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikata e

pronësisë së mjetit dhe leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore duhet të shoqërohet me kontratën noteriale të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) Për mjetet dhe paisjet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qera të tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për seciin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e paisjet teknike të deklaruar sipas shtojces Nr.10. (Deklaratë nga përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese)
- e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe paisjet e përshkruara më sipër të Kapaciteit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afait të kontratës objekt i prokurimi janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- f) **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma “a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.**

Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurim publik” i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet të përmbahen VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatoëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në përpjesëtim dhe përputhje me punët e marra përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Vetdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me blerë të përbashkët ose të veçanë, jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licenses profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti ishpaljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

**Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcatimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimi të dërgojë në**

**APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundim i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu periudhën e garancisë.**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/distributorin e autorizuar për materialet Tubo HDPE. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën që vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit për tubo HDPE të jetë në përputhje me standartin industrial ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018. Kontrata duhet të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Kontrata duhet të përmbajë certifikatën e origjinës së mallit, katalogë ose fragmente të katalogut ku tregohen specifikimet teknike të tubave HDPE dhe standarti/et e tubave të prodhuar sipas standartit EN12201-2, certifikata konformiteti apo teste laboratorikesi dhe të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për matësat e ujit ku tregohen specifikimet teknike (referuar katalogëve apo fragmente të katalogëve ku të tregohet se materiali i ofruar është sipas standardit të kërkuar etj.), analiza laboratorike ose certifikata konformiteti. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratën e furnizimit ose autorizim distributori/prodhuesi dhe certifikatën që vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit të matësave të jetë në përputhje me standartin ISO 9001:2015 së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese, me qëllim verifikim e origjinës së artikujve dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Me anë të kësaj skede teknike ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me ato të deklaruara në ofertë dhe të prodhuara nga kompani të certifikuar sipas standardit ISO 9001: 2015.

Operatori ekonomik/Bashkimi i operatorëve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt skualifikimi nga procedura.

Katalogët duhet të paraqiten së bashku me dokumentet e tjera *në gjuhën shqipe ose të përkthyerat të noterizuara*

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare e të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë shërbimi me një laborator testimi të materialeve të ndërtimit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtarë ose ndërkombëtarë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizat e çmimeve për të gjitha zërat e preventivit, metodologjinë dhe plan-organizimin e punimeve si dhe planin e sigurisë dhe shëndetit në punë në objekt sipas kërkesave të përcaktuara nga KTP dhe KTZ në fuqi.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë

kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

## **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## **Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

### **PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

Sipas preventivit të paraqitur në spe.

**Shtojca15**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore



## Dokumenta Standarde të Tenderit

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

<Emri>

### Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## **Shtojca 18**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate.Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtën ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor



- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

**Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

**Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
